




Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27515
Më 3.2.2015

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimit të mjeteve për pagesë të faturës së KRU “Hidroregjioni Jugor” ShA , kryetari i Komunës, më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimit të mjeteve financiare për pagesë të faturës së KRU “Hidroregjioni Jugor” ShA Prizren, për kyçjen në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit të objektit të ri të Bibliotekës së qytetit, kështu që për këtë qëllim dhe në emër të pagesës së faturës, lejohen mjetet në vlerë 1102 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave dhe shërbimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorive tjera komunale .
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KRU “Hidroregjioni Jugor” si dhe Arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja